



**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Duke u bazuar në nenin 21.4 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111, Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. - Pejë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 02.07.2026, e shqyrtoi çështjen e skadimit të mandatit të Zyrtarit Kryesor Financiar dhe lidhur me këtë çështje, me "tre" vota për, mori këtë:

V E N D I M no. 13

- I. Të shpallet konkursi publik për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar të K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. – Pejë.

A r s y e t i m

Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Pejë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 02.07.2026, shqyrtoi çështjen e skadimit të mandatit të Zyrtarit Kryesor Financiar.

Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se mandati i Zyrtarit Kryesor Financiar përfundon me dt. 03.07.2026, rrjedhimisht është krijuar baza ligjore për fillimin e procedurës së plotësimit të kësaj pozite, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së funksionimit të rregullt të shoqërisë dhe ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Për realizimin e këtij vendimi dhe zhvillimin e procedurës në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e brendshme të shoqërisë, Bordi autorizon Sekretarin e K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Pejë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shpalljen e konkursit publik.

Për këto arsye, Bordi i Drejtorëve, me "tre" vota "për" vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve
Qendresa Kukaj – Prelvukaj



Ju dërgohet:

- Bordit të Drejtorëve;
- NjPMNP-së;
- Arkivit.